

**MARRËVESHJE STANDARDE  
MES  
PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM  
DHE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË**

**MBI ZBATIMIN E PROJEKTIT "ZGJERIMI I SHËRBIMEVE TË NDIHMËS JURIDIKE FALAS PËR GRATË DHE  
BURRAT NË SHQIPËRI"**

I/E nderuar,

1. Duke iu referuar bisedimeve që janë zhvilluar mes punonjësve të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri (këtu e më poshtë referuar "PNUD") dhe punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar "MD") në lidhje me ofrimin e shërbimeve nga MD për zbatimin e Projektit për "Zgjerimin e Shërbimeve të ndihmës Juridike Falas për gratë dhe burrat në Shqipëri" (EFLAS), i cili zbatohet nga PNUD në partneritet me MD dhe me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.
2. Në përputhje me aktivitetet e Projektit EFLAS, si dhe me termat dhe kushtet e mëposhtme, ne konfirmojmë se pranojmë aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga MD, siç përcaktohet në Shtojcën 1: Përshkrim i Aktiviteteve (këtu e më poshtë referuar "Aktivitetet").
3. MD do të jetë tërësisht përgjegjëse për të zbatuar të gjitha Aktivitetet me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, si dhe në përputhje të plotë me rregullat financiare të shtetit shqiptar.
4. Për sa i përket zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara me hollësi në këtë Marrëveshje, personeli i MD dhe punonjësit me trajnim të posaçëm nuk do të konsiderohen në asnjë aspekt si punonjës apo përfaqësues të PNUD-it. PNUD-i nuk pranon asnjë përgjegjësi lidhur me pretendime ligjore që lindin nga veprime apo mosveprime nga ana e MD apo personelit të saj, apo të kontraktuarve të saj apo personelit të këtyre të fundit, gjatë kryerjes së Aktiviteteve apo ndonjë pretendim ligjor për vdekje, plagosje, paaftësi, dëme në pronë apo rreziqe të tjera që mund të pësojë MD apo personeli saj si pasojë e zbatimit të Aktiviteteve.
5. Marrëdhënia e punësimit e punonjësive me trajnim të posaçëm të 8 (tetë) qendrave ekzistuese të Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas do të administrohet në përputhje me rregullat dhe rregulloret e MD. Punonjësit me trajnim të posaçëm do të punojnë nën mbikëqyrjen e MD/Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas (DoFLA) dhe do të mbajnë përgjegjësi para MD/DoFLA për mënyrën e kryerjes së funksioneve të caktuara. MD do të sigurojë shërbimin në vazhdim të punonjësve me trajnim të posaçëm në pozicionet e caktuara përtej përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.
6. Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, PNUD-i do të kryejë pagesat drejt MD në përputhje me kalendarin e pagesave të përcaktuar në Shtojcën 1.
7. MD nuk do të marrë asnjë angazhim financiar dhe nuk do të kryejë asnjë shpenzim që e tejkalon buxhetin e caktuar për zbatimin e Aktiviteteve, siç parashikohet në Shtojcën 1. MD do të konsultohet rregullisht me PNUD-in lidhur me gjendjen dhe përdorimin e fondeve si dhe do ta informojë menjëherë PNUD-in në rast se MD është në dijeni që buxheti për zbatimin e këtyre Aktiviteteve është i pamjaftueshëm për zbatimin e plotë të

projektit, në përputhje me mënyrën e parashtruar në Shtojcën 1. PNUD-i nuk do të ketë asnjë detyrim për t'i dhënë fonde MD apo për t'i kompensuar kësaj të fundit shpenzime që shkojnë përtej totalit të buxhetit të përcaktuar në Shtojcën 1.

8. MD do të dorëzojë raportin e parë narrativ dhe financiar përkatësisht brenda muajit shtator 2021 dhe raportin e dytë narrativ dhe financiar brenda muajit dhjetor 2021. Raporti do t'i dorëzohet PNUD-it përmes Përfaqësuesit/es së Përhershëm të PNUD-it në vend. Format i raportit do të jetë ai i raportit standard të shpenzimeve të PNUD, një kopje e këtij formati do të sigurohet nga PNUD.

9. MD do të dorëzojë raporte progresi në lidhje me aktivitetet e zhvilluara, sikundër mund të kërkohet në mënyrë të logjishme nga menaxheri i projektit, përgjatë kohës së zbatimit të tij.

10. MD do të paraqesë një raport përfundimtar jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit apo ndërprerjes të projektit, ku do të përfshihet një listë e pajisjeve të blera nga MD si dhe të gjitha pasqyrat financiare dhe regjistrat e audituara apo çertifikuara që lidhen me aktivitetet e projektit në fjalë, bazuar në Rregulloret dhe Rregullat Financiare financiare të MD.

11. Të gjitha pajisjet apo mjetet që mund të ofrohen nga PNUD-i apo të jenë siguruar përmes fondeve të PNUD-it do të përdoren apo mbeten në pronësi, sipas marrëveshjes me shkrim që do të bihet dakort dhe do të nënshkruhet ndërmjet PNUD dhe MD.

12. Çfarëdolloj ndryshimi në dokumentin e projektit që mund të ndikojë mbi punën e kryer nga MD në përputhje me Shtojcën 1, rekomandohet të bëhet vetëm pas konsultimeve mes palëve.

13. Për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë në mënyrë specifike nën këtë Marrëveshje, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Dokumentin e Projektit apo në versionet e ndryshuara të tij, si dhe dispozitat përkatëse të Rregulloreve dhe Rregullave Financiare të MD dhe PNUD-it.

14. Rregullimet e parashtruara në këtë Marrëveshje do të mbeten në fuqi deri në përfundim të projektit, ose deri në përfundim të aktiviteteve të MD sipas përcaktimeve në Shtojcën 1, ose deri sa kjo marrëveshje të anulohet me shkrim (me njoftim paraprak prej të paktën 30 ditëve përpara) nga ndonjëra nga palët. Kalendari i pagesave i përcaktuar në Shtojcën 1 do të mbetet në fuqi, në bazë të performancës së realizimit të aktiviteteve në mënyrë të vazhdueshme nga ana e MD, përveç rasteve kur kjo e fundit merr njoftim me shkrim nga PNUD-i për të kundërtën.

15. Çdo fond i pashpenzuar dhe i paangazhuar pas përfundimit të Aktiviteteve do t'i kthehet PNUD brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve.

16. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të kryhet me marrëveshje të përbashkët, me shkrim.

17. Çdo korrespondencë e ardhshme lidhur me këtë Marrëveshje, përveç marrëveshjeve të nënshkruara apo ndryshimeve përkatëse, duhet t'i drejtohen znj. Limya Eltayeb, Përfaqësuese e Përhershme e PNUD-it në Shqipëri, Rr. Skënderbeu, Ndërtesa e Volkswagen, kati 2-të, Tiranë, Shqipëri.

18. MD do ta mbajë të informuar Përfaqësuesen e Përhershme e PNUD-it në Shqipëri në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha veprimet e ndërmarra prej saj në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

19. PNUD mund të pezullojë këtë Marrëveshje, tërësisht ose pjesërisht, me njoftim me shkrim, nëse linden rrethana që rrezikojnë përfundimin e suksesshëm të Aktiviteteve.

20. Çdo mosmarrëveshje mes PNUD-it dhe MD që vjen si pasojë apo ka lidhje me këtë Marrëveshje, dhe që nuk zgjidhet përmes negociatave apo rrugëve të tjera të pranura të zgjidhjes, do t'i paraqitet një Gjykatë të përbërë prej tri arbitrash. Secila palë do të caktojë një arbitër, ndërsa dy arbitrat e caktuar do të caktojnë të tretin, i cili do të jetë edhe kryetar i Gjykatës të Arbitrazhit. Nëse arbitri i tretë nuk caktohet brenda 15 ditëve nga caktimi i dy arbitrave të parë, secila prej palëve mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të caktojë këtë arbitër të tretë si më lart. Gjykata e Arbitrazhit do t'i përcaktojë vetë procedurat e saj, me kusht që çdo dy arbitra do të përbëjnë kuorumin për të gjitha qëllimet dhe të gjitha vendimet të kërkojnë miratimin e të paktën dy arbitrave. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të përballohen nga palët, sipas vlerësimit të Gjykatës së Arbitrazhit. Vendimi i arbitrazhit do të përmbajë një deklaratë e cila do të parashtrijë arsyet mbi të cilat ky vendim është bazuar dhe do të jetë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për të gjitha palët.

21. Nëse bini dakord me dispozitat e parashikuara më lart, ju lutem nënshkruani dy kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe dërgojini në këtë zyrë. Pranimi nga ana juaj përbën bazë për pjesëmarrjen e MD në zbatimin e projektit.

E juaja sinqerisht,

Nënshkruar në emër të PNUD-it



  
Limya Eltayeb  
Përfaqësuese e Përhershme e PNUD-it në  
Shqipëri

\_\_\_ Korrik 2021

Nënshkruar në emër të Ministrisë së  
Drejtësisë



  
Etilda Gjonaj  
Ministre e Drejtësisë

\_\_\_ Korrik 2021

Prot. 3760/2     Dt. 24.08.2021

## Plani i Aktiviteve, Logjistikës dhe Pagesave

PRODUKTET E PRITSHME dhe indikatorët, përfshi targetet	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA Liston të gjitha aktivitetet e planifikuara	Planifikuar	Buxheti		Pagesat e marra	Me nënshkrimin (50%)	Pas dorëzimit të raportit të parë narrativ dhe financiar Shtator 2021 (40%)	Pas dorëzimit të raportit të dytë narrativ dhe financiar Dhjetor 2021 (10%)
			Përshkrimi i Buxhetit në ALL	Shuma ALL				
Output 1: Tetë (8) qendrat ekzistuese të NJPF të fuqizuara më tej për të rritur aksesin në drejtësi të grave dhe burrave vulnerabël.	Act. 1.1: Ofrimi i shërbimeve të NJPF për të gjithë burrat dhe gratë vulnerabël nga 16 punonjës me trajnim të posaçëm në 8 qendrat ekzistuese të NJPF në Peshkopi, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Pogradec.	7,097,647.00	7,097,647.00			3,548,823.66	2,839,058.93	709,764.73
Output 2: Standardet dhe cilësia e NJF sigurohen përmes monitorimit të vazhdueshëm nga DNJF sipas kuadrit rregullator të miratuar.	Act. 1.2: Sigurimi i mjeteve logjistike të nevojshme për 8 qendrat ekzistuese NJF. Act. 2.1: Realizimi çdo tre (3) muaj i vizitave monitoruese nga DNJF i shërbimit NJF, parësor dhe dytësor in 8 rajonet e synuara nga projekti.	175,409.00	175,409.00			175,409.00		
Output 3: Vulnerable women and men reach with information on FLA, their rights and protecting mechanisms increased in 8 regions targeted by the Project. Rritja e numrit të grave dhe burrave vulnerabël të arritur me informacion mbi NJF, të drejtat e tyre dhe mekanizmat mbrojtës në 8 rajone të synuara nga Projekti.	Act. 3.1: Prodhim i materialeve të vizibilitetit për shërbimin e NJF të ofruar në 8 qendrat. Act 3.2: Organizimi i sesioneve periodike informuese me aktorët lokalë dhe komunitetet në 8 rajone të synuara për të informuar dhe rritur ndërgjegjësimin mbi sistemin dhe shërbimin e NJF.	120,000.00	120,000.00			120,000.00		
		149,730.00	149,730.00			74,865.00	74,865.00	
	<b>TOTAL</b>	<b>7,820,856.81</b>	<b>7,820,856.81</b>			<b>4,058,133.15</b>	<b>3,052,958.93</b>	<b>709,764.73</b>

## Shënim:

- Shpenzimet për personelin janë të kufizuara në pagë dhe të drejta të tjera, sipas rregullave dhe rregulloreve të MD/DNJF.

- Rregullimet brenda secilit prej seksioneve mund të bëhen në konsultim midis PNUD dhe MD/DNJF. Rregullime të tilla mund të bëhen nëse ato janë në përputhje me dispozitat e LD-së dhe



## Shtojca. 1

## Korrik – Dhjetor 2021

## Plani i Aktiviteteve, Logjistikës dhe Pagesave

PRODUKTET E PRITSHME dhe indikatorët, përfshi targetet	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA Liston të gjitha aktivitetet e planifikuara	Planifikuar	Buxheti	Pagesat e marra	Me nënshkrimin (50%)	Pas dorëzimit të raportit të parë narrativ dhe financiar Shtator 2021 (40%)	Pas dorëzimit të raportit të dytë narrativ dhe financiar Dhjetor 2021 (10%)
		Përkrahimi i Buxhetit në ALL	Shuma ALL				
<b>Output 1:</b> Tetë (8) qendrat ekzistuese të NJPF të fuqizuara më tej për të rritur aksesin në drejtësi të grave dhe burrave vulnerabël.	<b>Act. 1.1:</b> Ofrimi i shërbimeve të NJPF për të gjithë burrat dhe gratë vulnerabël nga 16 punonjës me trajnim të posaçëm në 8 qendrat ekzistuese të NJPF në Peshkopi, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Pogradec.	7,097,647.00	7,097,647.00		3,548,823.66	2,839,058.93	709,764.73
<b>Output 2:</b> Standardet dhe cilësia e NJF sigurohen përmes monitorimit të vazhdueshëm nga DNJF sipas kuadrit rregullator të miratuar.	<b>Act. 1.2:</b> Sigurimi i mjeteve logjistike të nevojshme për 8 qendrat ekzistuese NJF. <b>Act. 2.1:</b> Realizimi çdo tre (3) muaj i vizitave monitoruese nga DNJF i shërbimit NJF, parësor dhe dytësor in 8 rajonet e synuara nga projekti.	175,409.00 278,070.00	175,409.00 278,070.00		175,409.00 139,035.00	139,035.00	
<b>Output 3:</b> Vulnerable women and men reach with information on FLA, their rights and protecting mechanisms increased in 8 regions targeted by the Project. Rritja e numrit të grave dhe burrave vulnerabël të arritur me informacion mbi NJF, të drejtat e tyre dhe mekanizmat mbrojtës në 8 rajone të synuara nga Projekti.	<b>Act. 3.1:</b> Prodhimi i materialeve të vizibilitetit për shërbimin e NJF të ofruar në 8 qendrat. <b>Act 3.2:</b> Organizimi i sesioneve periodike informuese me aktorët lokalë dhe komunitetet në 8 rajone të synuara për të informuar dhe rritur ndërgjegjësimin mbi sistemin dhe shërbimin e NJF.	120,000.00 149,730.00	120,000.00 149,730.00		120,000.00 74,865.00	74,865.00	
	<b>TOTAL</b>	<b>7,820,856.81</b>	<b>7,820,856.81</b>		<b>4,058,133.15</b>	<b>3,052,958.93</b>	<b>709,764.73</b>

## Shënimi:

- Shpenzimet për personelin janë të kufizuara në pagë dhe të drejta të tjera, sipas rregullave dhe rregullore të MD/DNJF.
- Rregullimet brenda secilit prej seksioneve mund të bëhen në konsultim midis PNUD dhe MD/DNJF. Rregullime të tilla mund të bëhen nëse ato janë në përputhje me dispozitat e LD-së dhe



- **Drejtuar:** Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) Shqipëri
- **Subjekti:** Propozim për një marrëveshje bashkëpunimi midis Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe Ministrisë së Drejtësisë (MD) për të vazhduar zbatimin e projektit: "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri"

*Të nderuar përfaqësues të PNUD:*

Referuar Marrëveshjes Standarde të nënshkruar midis PNUD dhe MD në korrik 2020, siç specifikohet në Shtojcën 1, PNUD në partneritet me Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) do të mbështesë MD për ngritjen e 5 qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe riaktivizimin e 3 qendrave ekzistuese.

Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, aktualisht, MD në partneritet me PNUD dhe Agjencinë Austriake për Zhvillim (ADA) ka ngritur 5 qendra të ndihmës juridike parësore në Gjirokastrë, Pogradec, Vlorë, Shkodër dhe Dibër dhe gjithashtu ka riaktivizuar 3 qendra të ndihmës juridike parësore në Durrës, Fier dhe Lezhë.

Në kushtet kur 8 qendrat e NJF janë plotësisht funksionale dhe duke marrë në konsideratë pamjaftueshmërinë e buxhetit të shtetit për mbështetjen e këtyre shërbimeve për vitin e ardhshëm, DNJF propozon vazhdimin e partneritetit dhe mbështetjes së PNUD në konsolidimin e mëtejshëm të 8 qendrave ekzistuese të ndihmës juridike falas përmes një letre të re dakordësie në zbatim të projektit "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri".

Në këtë kontekst, përmes Marrëveshjes së re Standarde midis PNUD dhe MD, MD/DNJF mbeten të angazhuara të sigurojnë ofrimin e pandërprerë të shërbimeve të NJF në 8 qendrat ekzistuese të NJF për periudhën korrik - dhjetor 2021, me angazhimin e DNJF për të financuar dhe menaxhuar me fonde shtetërore të paktën tre deri në katër nga qendrat ekzistuese të NJF (të mbështetura aktualisht nga PNUD) në gjysmën e dytë të 2022 (korrik - dhjetor) dhe pjesa tjetër e qendrave ekzistuese për 2023.

Produkte dhe aktivitetet e propozuara janë si vijon më poshtë.

**Produkti 1:** Tetë (8) qendrat ekzistuese të NJPF të fuqizuara më tej për të rritur aksesin në drejtësi të grave dhe burrave vulnerabël.

Për zbatimin e këtij objekti, janë përcaktuar aktivitetet e mëposhtme:

**Aktiviteti 1.1:** Ofrimi i shërbimeve të NJPF për të gjithë burrat dhe gratë vulnerabël nga 16 punonjës me trajnim të posaçëm në 8 qendrat ekzistuese të NJPF në Peshkopi, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Gjirokastrë dhe Pogradec.

(Targeti: 3200 raste të ndihmës juridike parësore të ofruara nga qendrat për të gjithë kohëzgjatjen e projektit)

**Aktiviteti 1.2:** Sigurimi i mjeteve logjistike të nevojshme për 8 qendrat ekzistuese NJF.

*(Targeti: Plotësimi i nevojave të 8 qendrave përmes realizimit të procedurave të prokurimit nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas)*

**Produkti 2:** Standardet dhe cilësia e NJF sigurohen përmes monitorimit të vazhdueshëm nga DNJF sipas kuadrit rregullator të miratuar.

Për zbatimin e këtij objektivi, janë përcaktuar aktivitetet e mëposhtme:

**Aktiviteti 2.1:** Realizimi çdo tre (3) muaj i vizitave monitoruese nga DNJF i shërbimit NJF, parësor dhe dytësor in 8 rajonet e synuara nga projekti.

*(Targeti: Monitorimi i 8 qendrave çdo tre muaj sipas përcaktimeve të metodologjisë)*

**Produkti 3:** Vulnerable women and men reach with information on FLA, their rights and protecting mechanisms increased in 8 regions targeted by the Project. Rritja e numrit të grave dhe burrave vulnerabël të arritur me informacion mbi NJF, të drejtat e tyre dhe mekanizmat mbrojtës në 8 rajone të synuara nga Projekti.

Për zbatimin e këtij objektivi, janë përcaktuar aktivitetet e mëposhtme:

**Aktiviteti 3.1:** Prodhimi i materialeve të vizibilitetit për shërbimin e NJF të ofruar në 8 qendrat.

*(Targeti: 8 banera të prodhuara për çdo qendër të NJF.)*

**Aktiviteti 3.2** Organizimi i sesioneve periodike informuese me aktorët lokalë dhe komunitetet në 8 rajone të synuara për të informuar dhe rritur ndërgjegjësimin mbi sistemin dhe shërbimin e NJF.

*(Targeti: 1 aktivitet çdo 3 muaj në secilën qendër të NJF për të promovuar shërbimin e ndihmës juridike falas ndaj qytetarëve në nevojë)*

Si pjesë e zbatimit në vijimësi të projektit (duke filluar nga korrik 2021), subjekt i një marrëveshjeje të re midis UNDP dhe MD/FLAD, ju lutemi gjeni bashkangjitur:

- *Draft Marrëveshjen Standarde mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe Ministrisë së Drejtësisë (MD) për vijimin e zbatimit të projektit: "Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri"*
- *Draft Shtojcën nr. 1: Plani i Aktiviteteve, Logjistikës dhe Pagesave.*

*Juaji sinqerisht,*

**Ergys Qirici**

**Drejtore i Përgjithshëm,**

**Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas**

